



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e mjedisit dhe Planifikimit hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog planiranja
Ministry of Environment, Spatial and Planning

Ministria e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Kosovës, të nenit 11 nënparagrafi 1.5 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 34/2022), të nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-189 Për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenit 17 nënparagrafi 1.1 i Rregullores Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, nenit 14 dhe 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013), të nenit 21 dhe 27 të Ligjit Nr. 04/L – 110 për Ndërtim, të nenit 11, 43, 73 dhe 74 të Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, nenit 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 04/L - 087 Për Parkub Kombëtarë “SHARRI”, nenit 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 04/L - 086 për Parkun Kombëtarë “BJESHKËT E NEMUNA”, të nenit 26 dhe 27 të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 50/2009), në pajtim me Rregulloren MMPH nr.21/2013 për Rendim e Brendshëm të Parqeve Kombëtare, si dhe dispozitave të tjera ligjore përkatëse në fuqi nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndalohet rreptësisht çdo lloj aktiviteti ndërtimor brenda zonave strikte dhe zonave të menaxhuara të Parqeve Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri" në Republikën e Kosovës pa leje!
2. Ndalohet rreptësisht hyrja, transporti dhe qarkullimi për të gjitha mjetet e transportit që bartin çdo lloj materiali ndërtimor, mjetet e rënda të punës (eskavatorë, betonierë, buldozerë, kamionë vetëshkarkues) dhe makineritë e specializuara për ndërtim brenda zonave të Parqeve Kombëtare në Republikën e Kosovës, pa leje apo autorizim të posaçëm të lëshuar nga Ministria.
3. Me qëllim parandalimin e dëmit të pariparueshëm, autoritetet kompetente kanë të drejtën e ndalimit dhe sekuestrimit të përkohshëm të mjeteve dhe materialeve që tentojnë hyrjen pa leje.

Masa e sekuestrimit të përkohshëm zbatohet përmes një Procesverbalit Konstatimi, i cili duhet të përmbajë detaje të mjetit, tentativës, vendndodhjen ekzakte (koordinatat GPS) dhe provat fotografike/filmike të tentativës. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet subjektit.

Të gjitha shpenzimet për zhvendosjen e mjetit (shërbimi i bartjes me rimorkio speciale të mjeteve të rënda) dhe ruajtjen e tij në vendet e përcaktuara nga autoriteti, përballohen plotësisht nga subjekti shkelës.

Ne afat prej 3 (tre) ditësh nga momenti i sekuestrimit të përkohshëm, autoriteti kompetent nxjerr një Akt Administrativ të arsyetuar për bllokimin e mjetit si mjet i kryerjes së shkeljes.

4. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohet vendosja e menjëhershme e Pikave të Kontrollit në të gjitha akset rrugore hyrëse drejt Parqeve Kombëtare.
5. Pikat e kontrollit do të menaxhohen nga Drejtoria për Administrimin e Parqeve Kombëtare (DAPK) në koordinim dhe mbështetje të vazhdueshme nga Inspektorati Qendror i Mjedisit. Çdo mosveprim i zyrtarëve përgjegjës do të konsiderohet "Keqpërdorim i detyrës zyrtare".
6. Përveç gjobave administrative, Inspektorati obligohet menjëherë të dorëzojë kallëzim penal në Prokurorinë përkatëse për veprën penale "Ndërtimi pa leje" (sipas Kodit Penal të Kosovës).
7. Policia e Kosovës ngarkohet me ofrimin e asistencës së pandërprerë operacionale për të siguruar integritetin fizik të inspektorëve gjatë sekzekutimit të përkohshëm të mjeteve dhe materialeve.
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Ky Vendim nxirret si një masë urgjente mbrojtëse, duke u bazuar në gjetjet alarmante të raporteve të fundit zyrtare të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe monitorimit të terrenit nga portalet informative, të cilat konstatojnë një rritje alarmante e ndërtimeve pa leje dhe degradimit të qëllimshëm të mjedisit brenda zonave të mbrojtura. Ky aktivitet po shkakton humbje të biodiversitetit dhe dëmtim të habitateve natyrore, ndryshim të paligjshëm të destinimit të tokës, rrezikim të resurseve ujore dhe integritetit të ekosistemit.

Duke qenë se metodat e deritanishme administrative nuk kanë arritur të ndalin hovin e ndërtimeve ilegale, MMPH vlerëson se vendosja e pikave të kontrollit dhe sekuestrimi i përkohshëm i transportit të materialeve ndërtimore është masa e vetme efektive për të

parandaluar dëmin e pariparueshëm. Kjo masë është në proporcion të plotë me interesin publik për mbrojtjen e pasurisë kombëtare.

Përcaktimi për iniciimin e kallëzimeve penale dhe sekuestrimi i mjeteve në vendin e ngjarjes bëhet me qëllim të sigurimit të provave dhe parandalimin e recidivizmit (përsëritjes së veprës). Përfshirja e Policisë së Kosovës është e domosdoshme për të garantuar zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e zyrtarëve shtetërorë nga kanosjet e mundshme gjatë detyrës zyrtare.

Në konsideratë të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm dhe obligimit ligjor për të ruajtur monumentet e natyrës për brezat e ardhshëm, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministres të MMPH-se;
- Sekretari i Përgjithshëm;
- DAPK;
- Inspektorati Qendror i Mjedisit;
- Ministria e Punëve të Brendshme ;
- Arkivi i MMPH-së.

Fitore Pacolli Dalipi

Ministre e MMPH-së

